- të përdoret shuma 10,000,446.41 lekë për projektin “ Ndërrhyrje rehabilituese në mure mbajtës dhe terrene në territorin e bashkisë, në kuadër të mbrojtjes civile”, bashkangjitur relacionit.

Këto ndërhyrje shërbejnë për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese , mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronave të tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike , në përputhje me pikën 3.1 gërma b të VKM-së.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

Drejtorja e MCPTSH

Drejtorja e PULMI

Drejtorja Juridike

Drejtorja e Menaxhimit Financiar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE

RELACION

**MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR
BASHKËFINACIMIN E PROJEKTEVE TË BASHKISË BERAT ME FINANCIM TË HUAJ.
(shtesë buxheti me fondin për shpenzime kapitale për pagesë TVSH dhe bashkëfinancim projekte me
financim të huaj”)**

Të nderuar Këshilltarë ,

Bashkia Berat, në zbatim të ligjit Nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” ,të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 19.01.2023 “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ka kërkuar mbështetje me fonde për bashkëfinancimet dhe mbulimin e kostos së TVSH për projektet e ndihmës suaj pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës në Kryeministri (SASPAC).

Agjencia SASPAC dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka miratuar kërkesën e Bashkisë Berat për mbulimin e bashkë-financimit për buxhetet e projektet e huaja si vijon:

1-Bashkëfinancim projekti me financim të huaj “ Smart Municipality Energy Project “ ,Programi 06260 “Shërbimet publike vendore”, Kodi i produktit 1020186, Shuma 5,690,000 Lekë.

Projekti “ Smart Energy “ financohet nga Qeveria Zviceriane nëpërmjet Kooperimit Zvicerian SECO me kontributin 20% të bashkëfinancimit të Bashkisë Berat .

Vlera totale e Projektit për Bashkinë Berat është 580,000 euro. Projekti për Bashkinë Berat po kryen ndërhyrje rehabilituese në ndricimin rrugor duke përdorur energjinë eficiente, rehabilitim të shtyllave dhe ndricuesve të rrugëve më poshtë:

- 1- Rruga “Antipatrea”.
- 2- Rruga “ Ura e Re” përfshirë daljen në Gorice dhe lidhjen me Velabishtin.
- 3- Shëtitorja “ Osumi”

2-Bashkëfinancim projekti me financim të huaj “Gjithëpërfshirje dhe fuqizim ekonomik në Ballkanin Perëndimor HELP“ Programi 10430 “Përkujdesja Sociale” ,Kodi i projektit 1020186 , shuma 2,320,000 Lekë.

Projekti "Help" financohet nga Qeveria Gjermane me kontributin 20 % të bashkëfinancimit të Bashkisë Berat. Projekti synon të përkrahë 40 bizneset e vogla me anë të granteve për pajisje.

3-Kryerje pagese e TVSH për projekt me financim të huaj "E-Natura" Programi 08220 "Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore" ,Kodi i projektit 1020186 ,shuma 256,128 Lekë.

Pagesa e TVSH do të kryhet për punimet e kryera në kuadër të punimeve për mini-kopshtet botanike.

4-Kryerje pagese e TVSH për projekt me financim të huaj "Kënd Lojërash në lagjen Dëshmorët e Kombit "Programi 06260 "Shërbimet publike vendore" ,Kodi i projektit 1020186 ,shuma 187,800 Lekë.

Fondet që do përdoren nga granti i ardhur nga MFE janë me destinacion të përcaktuar si më sipër. Bashkia Berat në këtë mënyrë kursen nga buxheti i saj fondet në shumën 8,453,928 lekë,të cilat ishin parashikuar për bashkë-financime për vitin 2023 për projektet më sipër.

Kërkojmë miratimin nga ana juaj të përdorimit të fondeve të MFE për projektet më sipër.

Faleminderit,

DREJTORE E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE

Etleva Dhima

DREJTORE E FINANCË BUXHETIT

Rovena Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

**MBI MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË FONDEVE TË BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT "HELP ALBANIA"
SI FONDE TË RIMBURSUESHME NË PROJEKTIN "E- NATURA" .**

Të nderuar Këshilltarë ,

Bashkia Berat, në zbatim të ligjit Nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" ,të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 19.01.2023 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", ka kërkuar mbështetje me fonde për bashkëfinancimet dhe mbulimin e kostos së TVSH për projektet e ndihmës suaj pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës në Kryeministri (SASPAC).

Agjensia SASPAC dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka miratuar kërkesën e Bashkisë Berat për mbulimin e bashkë-financimit për buxhetet e projektet e huaja si vijon:

1-Bashkëfinancim projekti me financim të huaj "Gjithëpërfshirje dhe fuqizim ekonomik në Ballkanin Perëndimor HELP" Programi 04960 ,Kodi i projektit 90005AC ,shuma 2,320,000 Lekë.

Projekti "Help" financohet nga Qeveria Gjermane me kontributin 20 % të bashkëfinancimit të Bashkisë Berat.

Fondet që do përdoren nga granti i ardhur nga MFE janë me destinacion të përcaktuar si më sipër. Bashkia Berat në këtë mënyrë kursen nga buxheti i saj për projektin HELP, fondet në shumën 2,320,000 Lekë,të cilat ishin parashikuar për bashkë-financime për vitin 2023.

Nga ana tjetër, Bashkia Berat është duke përfunduar zbatimin e Projektit E-NATURA, programi buxhetor 8220 i cili financohet nga Programi IPA CBC Shqipëri- Greqi i Komisionit Europian. Për shkak të mbylljes së projektit dhe vonësës së transfertave nga ana e Sekretariatit të fondeve IPA, kërkohet nga ana jonë të kryhen pagesat e fundit të projektit në shumën 2,300,000 lekë.

Për të kryer në kohë pagesat e fondeve të projektit E-Natura, kërkohet transferimin e fondeve të bashkë-financimit të Projektit HELP Albania në shumën 2,320,000 Lekë në llogarinë e projektit E Natura, si borxh i rimbursueshëm.

Pas kryerjes së transfertës nga ana e Sekretariatit të fondeve IPA CBC Shqipëri- Greqi, fondet e përdorura si borxh i rimbursueshëm në shumën 2,320,000 Lekë, do kthehen në llogarinë e Bashkisë Berat.

Kërkohet miratimin nga ana juaj të transferimit të fondeve të Projektit HELP Albania si borxh i rimbursueshëm për Projektin E Natura.

Faleminderit,

DREJTORE E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE

Etleva Dhima

DREJTORE E FINANCË BUXHETIT

Rovena Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat më ____/_05_/2023

RELACION

PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2023 TË BASHKISË BERAT ME FONDIN PËR RITJEN E PAGAVE PËR FUNKSIONET E FINANCUARA ME TRANSFERTË SEKTORIALE

Të nderuar këshilltarë !

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.242, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 234 datë 20.04.2022, të Këshillit të Ministrave “ Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar, Vendimit nr 240 datë 20.04.2023 “ Për një ndryshim në Vendimin nr. 350 datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave “ Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ndryshuar, dhe Vendmit nr. 241 datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr 175 datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë , në arsimin parauniversitar” të ndryshuar, Bashkisë Berat, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8321 datë 08.05.2023 “Dërgohet rritja e pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale”, i është akorduar fondi prej 10,702,718 lekë si Transfertë korrente e brendshme (art. 604) , për rritjen e pagave për:

- funksionin e arsimit parashkollor, fondi prej 8,013,518 lekë ,
- funksionin e arsimit parauniversitar, fondi prej 960,000 lekë,
- funksionin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, fondi prej 1,153,200 lekë,
- funksionin e ujitjes dhe kullimit, fondi prej 240,000 lekë,
- funksionin e administrimit të pyjeve, fondi prej 336,000 lekë.

Është e nevojshme që ky fond të detajohet në zërat e shpenzimeve Paga dhe Sigurime Shoqërore&Shëndetësore, si edhe të rishpërndahet dhe shtohet në buxhetin e vitit 2023 të njëjësive shpenzuese :

1. Bashkia Berat (qendra), total shtesa 1,153,200 lekë, në programin buxhetor 03280 “ Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”
2. Drejtoria Arsimore Bashkia Berat, total shtesa 8,973,518 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor” shuma 4,173,518 lekë për edukatorët/punonjësit arsimorë/punonjësit në Qendrat Kulturore të fëmijëve dhe 3,840,000 lekë për punonjësit mbështetës, në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm/parauniversitar” shuma 960,000 lekë.
3. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar, total shtesa 576,000 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 04240 “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit” shuma 240,000 lekë, dhe në programin buxhetor 04260 “Administrimi i pyjeve dhe kullotave” shuma 336,000 lekë.



REPublika e SHqipërisë

BASHKIA BERAT

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023"; Vendimit e Këshillit Bashkiak nr 100 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025" i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.242, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 234 datë 20.04.2022, të Këshillit të Ministrave " Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike" të ndryshuar, Vendimit nr 240 datë 20.04.2023 " Për një ndryshim në Vendimin nr. 350 datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave " Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 241 datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në Vendimin nr 175 datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar" të ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8321 datë 08.05.2023 "Dërgohet rritja e pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale",

propozojmë që në VKB nr 100 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025" i ndryshuar, të bëhet shtesa e buxhetit të vitit 2023 si më poshtë :

1. Të shtohet buxheti i vitit 2023 me 10,702,718 lekë me fondin për rritjen e pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale.

Detajimi i shtesës së buxhetit :

Shtesë:

Kod Inst.	Kap. Fin.	Programi	Llog.	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				1,153,200
		03280			Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	1,153,200
2102001	01.1	03280	600	9999999	Paga	988,000
2102001	01.1	03280	601	9999999	Sigurime shoqerore	165,200
2102005		Drejtoria Arsimore Bashkia Berat				8,973,518
		09120			Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor (edukatore/punonjes arsimore/punonjes ne Qendrat Kulturore te Femijeve"	4,173,518
2102005	01.1	09120	600	9999999	Paga	3,576,000
2102005	01.1	09120	601	9999999	Sigurime shoqerore	597,518
		09120			Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor (punonjes mbeshtetes)	3,840,000
2102005	01.1	09120	600	9999999	Paga	3,290,000
2102005	01.1	09120	601	9999999	Sigurime shoqerore	550,000
		09230			Arsimi i mesëm i përgjithshëm	960,000
2102005	01.1	09230	600	9999999	Paga	823,000
2102005	01.1	09230	601	9999999	Sigurime shoqerore	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

						137,000
2102022	Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar					576,000
		04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit			240,000
2102022	01.1	04240	600	9999999	Paga	200,000
2102022	01.1	04240	601	9999999	Sigurime shoqerore	40,000
		04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave			336,000
2102022	01.1	04260	600	9999999	Paga	300,000
2102022	01.1	04260	601	9999999	Sigurime shoqerore	36,000
					Total	10,702,718

Pas kësaj shtese: buxheti total i bashkisë Berat i vitit 2023 nga 1,501,501,800 lekë bëhet 1,512,204,518 lekë.

Ju faleminderit !

KRYETAR

Ervin DEMO

Drejtoria Arsimore Bashkia Berat

Drejtoria e Bujqësisë

Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Drejtoria Juridike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

**PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË
BERAT DHE TË NJËSIVE SHPENZUESE NË VARËSI TË SAJ**

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli i Ministrave me Vendimet nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, nr. 113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; nr. 326, datë 31.05.2023 ”Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, ka vendosur për ndryshimin e nivelit të pagave të punonjësve në institucionet e vetëqeverisjes vendore, duke caktuar kufijtë e pagave mujore të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë në këto institucione. Bashkia Berat për efekt page grupohet tek kategoria e bashkive me 50,001 – 100,000 banorë.

Për funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar, të cilët përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr. 328 datë 31.05.2023, janë bërë ndryshimet e pagës si më poshtë :

- Paga për funksionarët e zgjedhur të bashkisë , në kufijtë minimalë dhe maksimalë është rritur mesatarisht me 20 % (15% për kryetarin e bashkisë dhe 25% për funksionin nënkryetar)
- Paga për administratorët e njësive administrative, në kufijtë minimalë dhe maksimalë është rritur mesatarisht me 18 % (nga 10 % për administratorët e lagjeve të qytetit deri në 33% për administratorët e njësive administrative me më pak se 5,000 banorë)

Për nëpunësit civilë të bashkisë si edhe punonjësit me pagë grupi në njësitë në varësi, të cilët përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr. 328 datë 31.05.2023, ndryshimet e pagës janë bërë në komponentët e saj, si më poshtë :

- Paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, në kufijtë minimalë dhe maksimalë është rritur mesatarisht me 7.6 %, (nga 7 % për kategorinë I-b deri në 8.5% për kategorinë IV-b)
- Shtesa e nivelit të kualifikimit (paga e grupit) ka mbetur e pandryshuar për grupet 1 dhe 3 të diplomës së arsimit të lartë, dhe është rritur vetëm për grupin 2 të diplomës në masën 9.1%.
- Shtesa për vjetërsi në punë ka mbetur e pandryshuar; llogaritet në masën 2% të pagës së grupit, pas çdo viti pune, max deri në 25 vite.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Për punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, në bashki dhe në njësitë në varësi të saj, të cilët përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr. 326 datë 31.05.2023, kemi:

- Paga bazë është rritur mesatarisht me 16% (nga 14% për klasën VIII deri në 18% për klasën I).
- Shtesa për vjetërsi në punë ka mbetur e pandryshuar; llogaritet në masën 1% të pagës bazë, pas çdo viti pune, max deri në 25 vite.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1, shkronja “b”, neni 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2; në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 2, shkronja “c” dhe neni 5, ; në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113; në ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, neni 6 shkronja “c”, neni 9; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 01.03.2023 “ Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.05.2023 ”Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”; në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr 100 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025”,

Për Strukturën Organizative, Kategoritë/Klasat e pagave të administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në Varësi të Bashkisë Berat për vitin 2023, të miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 724 datë 13.12.2022,

Ju propozojmë nivelin e pagave sipas lidhjeve nr. 1, 2, 3, 4, që i bashkëlidhen këtij relacioni.

Numri i përgjithshëm i punonjësve në strukturën organike të vitit 2023 është 787.

Efektet financiare të ndryshimit të nivelit të pagave do të fillojnë nga data 01 prill 2023 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar i vitit 2023 për bashkinë dhe njësitë në varësi të saj.

Ndryshimi i nivelit të pagave ka një efekt financiar të llogaritur në shumën 49,852,365 lekë, nga të cilat :

- ✓ 30,729,385 lekë për shpenzimet e personelit që financohen nga fondet e veta të bashkisë
- ✓ 19,122,980 lekë për shpenzimet e personelit që financohen nga transfertat sektoriale, për funksionet e transferuara nga pushteti qendror në vitin 2016: arsimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

bazë përfshirë parashkollorin, arsimit mesëm, menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, administrimi i pyjeve dhe kullotave, rrjeti rrugor rural, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri, përkujdesi social tek qendra "Lira".

Në lidhje me këtë, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8321 datë 08.05.2023 "Dërgohet rritja e pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale" për bashkinë Berat është akorduar fondi prej 10,702,718 lekë. Ne i jemi drejtuar ministrisë për akordimin e diferencës së fondit të nevojshëm prej 8,756,389 lekë për përballimin e plotë të efektit financiar për këto funksione, që rrjedh nga zbatimi i VKM-së nr. 328 datë 31.05.2023.

Efekti financiar në shpenzimet e personelit që financohen nga Transferta Sektoriale

Njësia Shpenzuese	efekti financiar Lekë	transfertë sektoriale e akorduar	nevoja për shtesë të transfertës sektoriale
Total Paga & Sigurime	19,122,980	10,702,718	8,756,389
Bashkia Berat (MZSH)	817,073	1,153,200	
Agjencia e Shërbimeve Publike	529,600	-	529,600
Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	11,020,707	8,973,518	2,047,189
Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"	-	-	-
Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar	3,336,000	576,000	2,760,000
Qendra "Lira"	3,419,600	-	3,419,600

Efekti financiar në shpenzimet e personelit që financohen nga fondet e veta të bashkisë sipas Njësive Shpenzuese

Njësia Shpenzuese	efekti financiar Lekë
Total Paga & Sigurime	30,729,385
Bashkia Berat (Aparati)	9,930,175
Agjencia e Shërbimeve Publike	10,782,831
Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	6,355,379
Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"	2,365,000
Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar	1,296,000
Qendra "Lira"	-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Efektet financiare të rritjes së nivelit të pagave për funksionet që financohen nga fondet e veta të bashkisë dhe nga transferta e pakushtëzuar, shuma 30,729,385 lekë, do të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2023. Buxheti i vitit 2023 për shpenzime personeli është 609,814,323 Lekë. Në periudhën janar-maj 2023 plan buxheti i parashikuar për shpenzime për paga & sigurime ishte 258,337,781 lekë dhe realizimi faktik 227,681,812 lekë. Plani i 5-mujorit nuk është realizuar për 30,655,969 lekë, për arsye se ka vende vakante në strukturë, për të cilat nuk janë kryer procedura rekrutimi duke respektuar legjislacionin në fuqi; për periudhën e fushatës zgjedhore nuk lejohet emërimi i punonjësve të rinj në institucionet shtetërore sipas Kodit Zgjedhor. Numri i punonjësve sipas struktursës është 787 dhe numri faktik 743; vende vakante 44.

Nga ana e bashkisë gjithashtu është bërë kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për akordim fondesh edhe për mbulimin e efekteve financiare të VKM-ve të ndryshimit të nivelit të pagave, për punonjësit mbështetës, për shumën 17,185,000 Lekë. Jemi në pritje të shqyrtimit të nevojave tona .

Në këto kushte Ju kërkojmë të miratoni propozimin për nivelin e pagave sipas Lidhjeve Nr. 1,2,3,4 që i bashkëlidhen këtij relacioni.

Faleminderit!

KRYETAR

Ervin DEMO

Sekretar i Përgjithshëm

Drejtor i Burimeve Njerëzore

Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Drejtor Juridik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë e Beratit (qendra)

sipas VKM nr. 328, datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"

Emërtimi	Kategoria	Shtesa për Vjetërsi në %	Paga për Pozicion
Kryetar i Bashkisë	-	-	145,000
Nënkryetar i Bashkisë	-	-	125,000
Sekretar i Përgjithshëm	I-b	2%	91,000
Sekretar i Këshillit Bashkiak	II-b	2%	73,900
Ndihmës Sekretar i Këshillit Bashkiak	IV-b	2%	34,500
Drejtori i Kabinetit të Kryetarit	II-b	2%	73,900
Këshilltar në Kabinet	III-a/1	2%	70,000
Administrator në Njësitë Administrative me 20,001-50,000 banorë (Lagjet e qytetit Nr. 1, 2,3)	Lidhja 9 Pika 2	-	109,000
Administrator në Njësitë Administrative me 5,001-20,000 banorë (Otlak, Velabisht, Sinjë)	Lidhja 9 Pika 3	-	95,000
Administrator në Njësitë Administrative me më pak se 5,000 banorë (Roshnik)	Lidhja 9 Pika 4	-	80,000
Drejtor Drejtorie	II-b	2%	73,900
Përgjegjës sektori	III-a/1	2%	70,000
Specialist I, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	III-b	2%	56,000
Specialist II, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-a	2%	44,000
Specialist III, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-b	2%	34,500
Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit	III-a/1	2%	70,000
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit	III-b	2%	56,000

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit administrativë në Bashkinë e Beratit (qendra)

sipas VKM nr 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës , Lidhja Nr. II

Emërtimi	Klasa	Shtesa për Vjetërsi në %	Paga Bazë
Teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme Punonjës për parkimin dhe tregjet	V	1%	42,800
Punonjës mirëmbajtës Kujdestar i banesave sociale Shofer	III	1%	41,800
Roje Sanitare	I	1%	40,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit në njësitë spenzuese në varësi të Bashkisë së Beratit

sipas VKM nr. 328, datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"

EMËRTIMI	Kategoria	Shtesa për vjetërsi në %	Paga për pozicion
Drejtor në Njësitë Vartëse të Bashkisë	II-b	2%	73,900
Përgjegjës Sektori në Njësitë Vartëse të Bashkisë	III-a/1	2%	67,000
Përgjegjës Sektori në Njësitë Vartëse të Bashkisë	III-b	2%	56,000
Shef Finance në Njësitë Vartëse (Qendra Kulturore "Margarita Tutulani, Drejtorja e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar)	III-b	2%	56,000
Specialist I, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	III-b	2%	53,000
Specialist II, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-a	2%	43,000
Specialist III, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-b	2%	34,000
Përgjegjëse çerdheje	IV-a	2%	43,000
Bibliotekare	III-b	2%	53,000
Regjizor	III-b	2%	53,000
Koreograf	III-b	2%	53,000

Lidhja nr. 4 – Niveli i pagës për punonjësit administrativë në institucionet në varësi të Bashkisë së Beratit

sipas VKM nr 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës , Lidhja Nr. II

Emërtimi	Klasa	Shtesa për Vjetërsi në %	Paga Bazë
Llogaritare Arkiviste dhe vëzhguese në sallën e galerisë	VIII	1%	44,100
Fadromist dhe skrepist Fadromist mekanik Shofer kamioni Shofer transporti për mjet mbi 2.5 ton Shofer autokulle mbi 2.5 ton Specialist muzike	VII	1%	43,600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Specialist metodist ,menaxher aktivitetesh			
Teknik punimesh Edukatore në çerdhe Kuzhinier Teknik i mesëm Pyjesh Teknik për ujitjen dhe kullimin Topograf	V	1%	42,800
Magazinier Magaziniere, Arkiviste, Garderobë	IV	1%	42,500
Elektriçist + elektromekanik Hidraulik Inventarizuese Marangoz Mirembajtes kanalizues Punëtor dhe Bojaxhi Punonjës Mirëmbajtes Robraqepës Shofer Elektriçist për ndriçimin publik Manovrator, rrulist dhe mekanik Mirëmbajtës të gjelberimit dekorativ Punëtor asfaltimi Punëtor trotuari, kalldremxhi Punëtor mirembajtes Punëtor për mirembajtjen e varrezave publike në Njësite Administrative Animator për teatrin e kukullave Marangoz, punëtor skene Mirëmbajtës dhe pastrues terreni Punonjës ndricimi dhe fonie Punonjës skene dhe administ. godine Shofer transporti mjeti deri në 2.5 ton Punëtor mirëmbajtës për pyjet, ujitjen dhe kullimin	III	1%	41,800
Ndihmes kuzhinier	II	1%	41,000
Krasitës , Kositës, Trapjantues Lulishtarë Punëtor për hapjen e varreve (varrmihës) Punëtor për pastrimin e hapësirave te gjelbëruara Roje ne objekte te ndryshme Roje nate ne objekte te ndryshme Rrobalarëse Sanitare	I	1%	40,000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjet Nr.1 dhe Nr. 3, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit (mbi shtesën e nivelit të kualifikimit).
2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjet Nr. 2 dhe Nr. 4 , të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

3. Në Lidhjen Nr.1, Specialistët e IT me diplomë universitare të nivelit “Master i shkencave”/”Master profesional”/“Bachelor” apo të barasvlefshme me ta, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” , “Inxhinieri informatike”, “ Informatikë”, “Inxhinieri telekomunikacioni”, “Shkenca kompjuterike”, “Teknologji informacioni”, “Informatikë ekonomike”, “Informatikë biznesi”, “Inxhinieri matematike- informatike” dhe “Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh)”, prfitojnë shtesë për kushte pune (natyrë të veçantë pune) në masën 5,000 (pesë mijë) lekë në muaj.

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për grupet e diplomave të arsimit të lartë

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/ muaj)
1	Niveli 7 i KSHK Master i Shkencave, Master i Arteve Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14,000
2	Niveli 7 i KSHK Master profesional Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12,000
3	Niveli 6 i KSHK Bachelor Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10,000

KRYETAR

Ervin DEMO

Sekretar i Përgjithshëm

Drejtor i Burimeve Njerëzore

Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Drejtor Juridik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
